



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 116 Prot

Tiranë, më 12. 11. 2007

VENDIM Nr. 19 dt. 06. 11. 2007

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 06.11.2007, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës.

#### VENDOSI:

#### Të miratojë projektet:

1. Banesa Kadare, Gjirokastrë. (Pas zbulimit të gjurmëve të panjohura ndërtimore gjatë zbatimit të projektit, u miratua varianti i pjesës qendrore i hartuar nga Z. Latif Lazimi dhe varianti i shtesës së krahut të majtë i hartuar nga z. Agron Doraci. Kjo zgjidhje është miratuar plotësisht prej ish pronarit të banesës Z. Ismail Kadare)
2. Hidroizolimi i kalasë Gjirokastrë.
3. Projekt restaurimi i kishës së Shën Dhimitrit, Kërçisht, Peshkopi.
4. Projekt rikonstruksioni i mullirit të Blojës, Berat.
5. Projekt restaurimi banesa Rexhep Lleshi, Mat.
6. Projekt restaurimi banesa e familjes Shehu, Dibër.
7. Projekt restaurimi banesa e familjes Markaj, Dibër.
8. Projekt restaurimi banesa Agustin Jubani, Shkodër.
9. Projekt restaurimi banesa Pëllumb Lera, Shkodër.
10. Projekt restaurimi vëllazëria Lubonja, Korçë.

#### Për projektet:

- Projekt rikonstruksioni banesa Mihal Gërço, Elbasan. (Projekti u miratua në parim me kushtin që në shesh të kryhen gërmime arkeologjike dhe vendimi përfundimtar të merret pas raportit të gërmimeve arkeologjike. Për këtë do të lidhet një marrëveshje midis IMK dhe pronarit të banesës).
- Projekti i firmës së ndërtimit "G&XH" shpk, në sheshin e kullës 3 këndore, Durrës, u shty të diskutohet në mbledhjen e ardhshme, pasi të pajiset me një dokumentacion më të plotë (foto, skica, genplan)

**Nuk u miratua:**

- Projekt rikonstruksioni i kishës së "Shën e Premto" dhe "Shën Dionisi", Veskopojë, Korçë. (Të bëhet kërkesa për shpalljen e rrethojave monument kulture. Sheshi do tu nënshirohet gërmimeve arkeologjike. Do të ngrihet një grup pune të verifikojë gjendjen në terren).

**U miratuan propozimet për shpalljen monument kulture**

- Tuma e Kamenicës, Korçë
- Zona Arkeologjike e shpellës së Trenit, Korçë.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
PROF. DR. YLLI PANGO**



**SEKRETAR I K.K.R.  
LORENC BEJKO**

